



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.1648/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit Shoqëria për Prodhim “Kokrra e Artë” me seli në Maqedoni, e cila sipas autorizimit përfaqësohet nga avokate A.R.H. me zyre në Prishtinë, kundër debitorit Aroma Sh.p.k, me seli në Prishtinë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat F.S. me zyre në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1226/22, të datës 19.09.2023, me datë 05.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e kreditorit Shoqëria për Prodhim “Kokrra e Artë” ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1226/22, të datës 19.09.2023, **PRISHET** dhe çështja i kthehet Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së Parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1226/22, të datës 19.09.2023, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit Aroma Sh.p.k ashtu që pjesërisht është anuluar Urdhri Përmbartimor P.nr. 118/21 i datës 25.03.2021 të lejuar nga Përmbartues Privat Irfan I. Kërçagu për borxhin në lartësi prej 4,983.64 EUR dhe është përfunduar procedura në këtë pjesë të përmbartimit. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit Aroma Sh.p.k ashtu që ka lënë në fuqi pjesën tjetër të Urdhrit Përmbartimor P.nr. 118/21 të datës

25.03.2021 të lejuar nga Përmbaues Privat Irfan I. Kërçagu për borxhin në lartësi prej 3,766.36 EUR.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1226/22, të datës 19.09.2023, apo ndryshohet apo lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori ka ushtruar përgjigje në ankesë duke theksuar se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është i ligjshëm dhe nuk përmban asnjërin nga shkeljet e dispozitave të LPP-së andaj ka kërkuar nga Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë – Departamenti për Çështje Ekonomike të refuzoj në tërësi të pabazuar ankesën e kreditorit ndërsa të vërtetoj aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1226/22, të datës 19.09.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Shoqëria për Prodhim “Kokrra e Artë”, ka paraqitur propozimin për përmbaimit në bazë të dokumentit: faturë nr. 19/285 të datës 08.04.2019 duke urdhëruar debitorin që në emër të borxhit të papaguar nga faturat e lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 8,750.00 EUR, me kamatë ligjore prej 8% nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbaimore.

Përmbauesi privat ka aprovuar propozimin për përmbaimit e kreditorit dhe ka lejuar përmbaimit e propozuar në vlerë prej 8,750.00 EUR të lëshuar me urdhrin për përmbaimit P.nr.118/21 të datës 25.03.2021.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim përmes të cilit ka kontestuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbaimit, duke theksuar se faturat mbi bazën e të cilës është lejuar përmbaimit nuk është e përshtatshme për përmbaimit pasi që nuk është pranuar në mënyrë të

rregullt nga debitori. Tutje ka shtuar se debitori gjithnjë ka qenë i rregullt me pagesa tek kreditori, madje në raste të caktuara duke bërë edhe parapagime, ashtu që me datë 18.10.2019 ka bërë pagesë tek kreditori në vlerë prej 4,000.00 euro, dhe se nga kartela financiare e debitorit rezulton se borxhi tek kreditori është në shumën prej 3,766.36 euro. Ndërsa përgjatë seancës ka qëndruar në tërësi pranë pretendimeve të ngritura me prapësim duke sqaruar më tutje se pas lëshimit të faturës objekt i këtij përbarimi, debitori me datë 08.04.2019 ka bërë pagesë në vlerë prej 4,000.00 euro, ndërsa me datë 25.04.2019 ka bërë pagesë në vlerë prej 14,000.00 euro. Në këtë drejtim ka shtuar se nga kartela financiare e furnitorit, rezulton se totali i furnizimit ka qenë në vlerë prej 162,291.35 euro, ndërsa totali i pagesës ka qenë në vlerë prej 158.525.00 euro, andaj borxhi i mbetur nga debitori është në vlerë prej 3,766.36 euro. Mbi këtë bazë ka kërkuar nga Gjykata që urdhri për lejimin e përbarimit të shfuqizohet pjesërisht, dhe të mbetet në fuqi vetëm sa i përket vlerës prej 3,766.36 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Kreditori përgjatë seancës dëgjimore ka qëndruar në tërësi pranë propozimit për përbarim dhe përgjigjes ndaj prapësimit, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim dhe përgjatë seancës dëgjimore. Ka shtuar se nga pagesat e prezantuara nga debitori, nuk rezulton se të njëjtat i janë referuar pagesës së faturës nr. 19/285 mbi bazën e të cilave është lejuar përbarimi, ndërsa sa i përket kartelës financiare të debitorit, ky dokument nuk është aspak i besueshëm, sepse është krijuar ekskluzivisht për interesat e debitorit. Me kërkesë që të refuzohet prapësimi i debitorit ndërsa urdhri për lejimin e përbarimit të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1226/22, të datës 19.09.2023, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit Aroma Sh.p.k ashtu që pjesërisht është anuluar Urdhri Përbarimor P.nr. 118/21 i datës 25.03.2021 të lejuar nga Përbarues Privat Irfan I. Kërçagu për borxhin në lartësi prej 4,983.64 EUR dhe është përfunduar procedura në këtë pjesë të përbarimit. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit Aroma Sh.p.k ashtu që ka lënë në fuqi pjesën tjetër të Urdhrit Përbarimor P.nr. 118/21 të datës 25.03.2021 të lejuar nga Përbarues Privat Irfan I. Kërçagu për borxhin në lartësi prej 3,766.36 EUR.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se duke u bazuar në shkresat e lëndës, gjeti se debitori, pas lëshimit të faturës nr. 19/285 të datës 08.04.2019, ka bërë dy pagesa tek kreditori, dhe atë me datë 25.04.2019 pagesë në vlerë prej 14,000.00 euro, fakt ky që vërtetohet nga urdhërpagesa me nr. ref. 479650314, dhe pagesë në vlerë prej 4,000.00 euro me datë 18.10.2019, fakt ky që vërtetohet nga urdhërpagesa me nr. ref. 496957151, pjesë e shkresave të lëndës.

Në këtë drejtim, përkundër faktit që pagesat e lartcekura, nuk i referohen shprehimisht pagesës së faturës nr. 19/285 të datës 08.04.2019 mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarimi, Gjykata gjeti se nga totali i borxhit që debitori ka ngelur pa paguar tek kreditori kap vlerën prej 3,766.36 euro, shumë kjo që i referohet faturës nr. 19/285 objekt i këtij përmbarimi.

Deri tek ky vlerësim, Gjykata erdhi duke u bazuar në kartelën e klientit e debitorit, si dhe nga dëshmitë bankare të dorëzuara në seancën dëgjimore të datës 06.09.2023 nga debitori, dhe atë: urdhërpagesa nr. 468057075 e datës 03.01.2019 në vlerë prej 8,250.00 euro, urdhërpagesa nr. 469047025 e datës 14.01.2019 në vlerë prej 7,000.00 euro, urdhërpagesa nr. 474725373 e datës 07.03.2019 në vlerë prej 21,375.00 euro, urdhërpagesa nr. 476077355 e datës 21.03.2019 në vlerë prej 28,500.00 euro, urdhërpagesa nr. 476453160 e datës 25.03.2019 në vlerë prej 30,000.00 euro, urdhërpagesa nr. 476928249 e datës 28.03.2019 në vlerë prej 14,000.00 euro, urdhërpagesa nr. 477543480 e datës 02.04.2019 në vlerë prej 14,000.00 euro, urdhërpagesa nr. 477878485 e datës 05.04.2019 në vlerë prej 17,400.00 euro, urdhërpagesa nr. 479650314 e datës 25.04.2019 4 në vlerë prej 14,000.00 euro, dhe urdhërpagesa nr. 496957151 e datës 18.10.2019 në vlerë prej 4,000.00 euro. Nga këto urdhër pagesa, rezulton se nga totali i borxhit që debitori ka pasur tek debitori përgjatë bashkëpunimit afarist të vitit 2019, duke përfshirë edhe borxhin nga fatura nr. 19/285, ka qenë në shumë prej 162,291.35 euro, ndërsa totali i pagesës nga debitori në emër të këtij borxhi është në vlerë prej 158.525.00 euro, ashtu që diferenca e borxhit të papaguar nga debitori për kreditorin është në vlerë prej 3,766.36 euro, borxh ky i mbetur pa paguar për faturën objekt i këtij përmbarimi.

Gjykata Komerciale -Dhoma e shkalles se Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së.

Gjykata e Shkallës së Parë ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.118/21 të datës 25.03.2021 për shumën e borxhit prej 4,983.64, ndërsa të njëjtin urdher ka lënë në fuqi për borxhin në lartësi prej 3,766.36€ nga të cilat rrezulton se nga totali i borxhit që debitori ka pasur tek debitori përgjatë bashkëpunimit afarist të vitit 2019, duke përfshirë edhe borxhin nga fatura nr. 19/285, ka qenë në shumë prej 162,291.35 euro, ndërsa totali i pagesës nga debitori në emër të këtij borxhi është në vlerë prej 158.525.00 euro, ashtu që diferenca e borxhit të papaguar nga debitori për kreditorin është në vlerë prej 3,766.36 euro, borxh ky i mbetur pa paguar për faturën objekt i këtij përmbartimi. Ndërsa pas lëshimit të faturës nr.19/285 të datës 08.04.2019 ka bërë dy pagesa dhe atë me datë 25.04.2019 pagesë në vlerë prej 14,000.00 euro, fakt ky që vërtetohet nga urdhërpagesa me nr. ref. 479650314, dhe pagesë në vlerë prej 4,000.00 euro me datë 18.10.2019, fakt ky që vërtetohet nga urdhërpagesa me nr. ref. 496957151, pjesë e shkresave të lëndës. Gjykata e Shkallës së Parë ka gjetur se totali i borxhit të debitorit që ka ngelur pa u paguar kap vlerën prej 3,766.36 € shumë kjo që i referohet faturës nr.19/285, objekt i këtij përmbartimi dhe kjo bazuar në kartelën e klientit –debitorit si dhe nga dëshmitë bankare të dorëzuar në seancën dëgjimore.

Gjykata e Shkallës së dytë vlerëson se propozimi për përmbartim është inicuar mbi bazën e dokumentit të besueshëm- faturës nr.19/285 të datës 08.04.2019 në shumën prej 8,750.00€. Debitori në lidhje me faturën e lartcekur ka sjellur si dëshmi urdhërpagesa e poashtu edhe kartelën e klientit-debitorit që pasqyron borxhin që debitori ka pasur ndaj kreditorit përgjatë bashkëpunimit afarist të vitit 2019, duke përfshirë edhe borxhin nga fatura nr. 19/285, mirëpo kjo gjykatë vlerëson se kartela financiare e debitorit e datës 04.12.2018 nuk paraqet dokument të besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë sepse është e njëanshme dhe në kundërshtim me nenin 29 par. 1 nën par. 1.2 të LPP-së e po ashtu procedura përmbartimore nuk është inicuar mbi bazën e po atij dokumenti.

Ndërsa sa i përket urdhërpagesave të bashkangjitura pjesë e shkresave të lëndës ani pse debitori ka bërë vazhdimisht pagesa te kreditori duke iu referuar “pagesa për miell”, nuk mund të merren parasysh pasi që të njëjtat nuk vërtetojnë faktin se janë bërë pagesë për faturën për të cilën është inicuar procedura përmbartimore gjegjësisht faturën nr.19/285 sepse gjykata e shkallës së parë i është referuar kartelës së debitorit e cila nuk vërteton gjendjen faktike në mënyrë të drejtë për faturën e lartcekur.

Andaj, gjykata e shkallës së parë, nuk ka shqyrtuar drejtë çështjen, përkitazi gjetjes se një konstatimi të saktë sepse debitori nuk ka ofruar ndonjë provë konkrete për të vërtetuar shlyerjen e borxhit për faturën 19/285 ashtu siç ka vlerësuar shkalla e parë. Ashtu që me qëllim të harmonizimit të shkresave në lëndë, gjykata e shkallës së parë duhet të vlerësojë nëse fatura i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm konform dispozitave ligjore të LPP-së, prandaj, ankesën e kreditorit e pranoi si të themeltë dhe çështjen vendosi t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në ri procedurë, Gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, të vërtetojë në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike të vlerësojë dokumentin përmbartimor, se a i plotëson kushtet nga neni 29 par.3 të LPP-së, e pas kësaj të vazhdojë procedurën konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMA E SHKALLËS SË DYTË
Kom.Dh.Shk.II.nr.1648/23 me datën 05.03.2024

Gj y q t a r i,
Faton Bajrami